



Biografi e shkurtër

Jonida Hoxha, Këshilltare Ligjore

Zj.Jonida Hoxha është diplomuar “Jurist” në vitin 1999 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, me rezultate shumë të mira. Në vitin 2002 ka përfunduar Master në Studime Europiane, Universiteti i Tiranës.

Pas diplomimit, ka punuar si asistent-pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Prej shkurtit 2002 ka qenë pjesë e administratës së Kuvendit të Shqipërisë, duke punuar me përkushtim në pozicione të ndryshme (sekretare e Komisionit për Rendin dhe SHISH-in dhe specialiste në Drejtorinë e Seancave Plenare). Prej vitit 2005 e deri në janar 2018 ajo ka punuar si Këshilltare Juriste e Shërbimit Juridik, si dhe pranë Komisionit të përhershëm parlamentar për Punën,Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Ka qenë pjesë e grupeve të punës për hartimin e një sërë projektligjesh dhe si eksperte e kontraktuar nga organizatat ndërkombëtare në Shqipëri. Ka kryer trainime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, kryesisht për analizat ligjore, teknikën legislative dhe politikat e legjislacionin europian.

Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe franceze. Gëzon njohuri shumë të mira të gjuhës italiane.

Aktualisht është Këshilltare Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.